

Delegacija Evropske unije u Srbiji  
Vladimira Popovića 40/V, 11070 Novi Beograd  
Tel: +381 11 308 3200  
e-mail: [delegation-serbia@eeas.europa.eu](mailto:delegation-serbia@eeas.europa.eu)  
web: [www.europa.rs](http://www.europa.rs)

Centar za slobodne izbore i demokratiju – CeSID;  
Belimarkovićevea 9, 11000 Beograd  
Tel: +381 11 2852 886  
e-mail: [cesid@cesid.rs](mailto:cesid@cesid.rs)  
web: [www.cesid.rs](http://www.cesid.rs)



Projekat finansira Evropska unija  
u okviru EIDHR programa



# DORACAK PËR PJESMARRJEN E QYTETARËVE NË MARRJEN E VENDIMEVE NË PRESHEVË, BUJANOC DHE MEDVEGJË





---

**DORACAK PËR PJESMARRJEN E QYTETARËVE  
NË MARRJEN E VENDIMEVE  
NË PRESHEVË,  
BUJANOC DHE  
MEDVEGJË**

---

---

*Beograd, Shkurt 2017*



Projekat finansira Evropska unija  
u okviru EIDHR programa

# PËRMBAJTJA

---

3	PËRMBAJTJA
4	FJALA HYRËSE
7	1. MËNYRAT NËPËRMJET TË CILAVE QYTETARËT MUND TË MARRIN PJESË NË PROCESIN E MARRJES SË VENDIMEVE NË VETËQEVERISJET LOKALE
8	2. FORMAT E PJESMARRJES SË QYTETARËVE: INICIATIVAT QYTETARE, REFERENDUMI, KËSHILLI I QYTETARËVE, DISKUTIMET PUBLIKE, ANKETIMET PUBLIKE
8	INICIATIVAT QYTETARE
10	REFERENDUMI
11	TUBIM I QYTETARËVE
11	DISKUTIMET PUBLIKE
12	ANKETIMET PUBLIKE
13	3. ZGJEDHJET LOKALE
17	4. ROLI I BASHKËSIVE LOKALE
24	5. RËNDËSIA E BASHKËPUNIMIT ME ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE
26	6. KOMUNIKIMI NDËRMJET KËSHILLIT NACIONAL DHE QYTETARËVE
28	7. KONTAKTET E KOMUNAVE

## FJALA HYRËSE

---

Doracaku i cili ndodhet para Ju është njëri prej rezultateve të projektit „Mbështetja e demokratizimit në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë“ të cilin e realizon **Qendra për zgjedhje të lira dhe demokraci (CeSID) nga Beogradi**, në bashkëpunim me organizatat partnere International Human Center nga Presheva, Civil Resurs Centar nga Bujanoci dhe Organizata Jabllanica e Epërme nga Medvegja. Projekti „Mbështetja e demokratizimit në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë“ zgjatë nga Prilli i vitit 2016 deri në Prill të vitit 2017 dhe financohet nga Unioni evropian në kuadër të programit EIDHR.

Qëllimi i Doracakut është që të JU ofroj njohuri të detajizuara me terminin e participimit qytetarë, rrespektivisht mënyrat dhe hapat nëpërmjet të cilëve mund të merrni pjesë në marrjen e vendimeve me rëndësi në komunat e Juaja.

Këtu mund të gjeni të gjitha informacionet e rëndësishme mbi (1) *Mënyrat nëpërmjet të cilave mund të merrni pjesë në procesin e marrjes së vendimeve në komunat e juaja, rrespektivisht të gjithë dispozitave të cilat përshkruhen nëpërmjet akteve ligjore dhe nënligjore;* (2) *Format e pjesmarrjes së qytetarëve – incijativat qytetare, referendumet, tubimet e qytetarëve, diskutimet publike dhe anketimet publike;* (3) *Zgjedhjet lokale, të drejtën zgjedhore aktive dhe pasive;* (4) *Bashkësitë lokale dhe rolin e tyre;* (5) *Rëndësinë e bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile;* (6) *Këshillin nacional të pakicës nacionale dhe mënyrat e komunikimit midis Ju dhe këtij institucioni dhe* (7) *Kontaktet e komunave.*

Pjesa e veçant e Doracakut paraqet regjistrin e të gjithë bashkësive lokale në territoret e komunave Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë me emrat e kryetarëve të çdo bashkësie lokale, të cilëve mund t'i drejtoheni.

Doracaku, në radhë të parë, i është dedikuar masës së gjerë të popullsisë, rrespektivisht qytetarëve si akter të patejkalueshëm të procesit të marrjes së vendimeve, por edhe partive politike, politikanëve, organizatave të shoqërisë civile dhe medias.

Në Beograd, Shkurt 2017

**Emilija Brkić**

**Qendra për zgjedhje të lira dhe demokraci (CeSID)**

## 1. MËNYRAT NËPËRMJET TË CILAVE QYTETARËT MUND TË MARRIN PJESË NË PROCESIN E VENDIM-MARRJES NË NJËSITË E QEVERISJES LOKALE



Në mënyrë që t'iu ofrohen qytetarëve mënyrat nëpërmjet të cilave munden në forma të drejtpërdrejta të marrin pjesë në marrjen e vendimeve në njësitë e vetqeverisjes lokale, është e domosdoshme të fillohet nga kornizat normative të cilat rregullojnë këtë pjesëmarrje. Qëllimi i këtij publikimi është që në kapitujt e radhës në mënyrë sa më të thjeshtë dhe të pranueshme të prezentohen mundësit e mundshme të realizimit të të drejtës qytetare, në mënyrë që qytetarët të inkurajohen që të marrin pjesë në krijimin e politikave lokale. Në pika të shkurta do të përmendim aktet juridike më të rëndësishme dhe mënyrat me anë të së cilave rregullohet kjo sferë.

**Korniza legjislative** bazohet në Kushtetutën e Republikës së Serbisë dhe në aktet ligjore në fuqi:

**Ligji mbi vetqeverisjen lokale dhe Ligji mbi referendumin dhe iniciativën qytetare.**

Lënda e rregullimit kushtetues në këtë sferë është e rëndësishme për pjesëmarrjen e drejtpërdrejt të qytetarëve, dhe theksimin e referendumit dhe iniciativave si mekanizma për ushtrimin e pushtetit dhe sovranitetin e qytetarëve.

**Ligji mbi vetqeverisjen lokale** parasheh tri mënyra të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve: iniciativën qytetare (si formë e vendosjes) dhe tubimin e qytetarëve (si mënyrë për konstatimin e propozimeve dhe kërkesave të cilat u drejtohen organeve të vetqeverisjes lokale).

Në dy aktet e përmendura ligjore ndodhen dispozita identike në pjesën në të cilën thuhet që Kuvendi komunal mundet me vetë iniciativë të shpallë referendum mbi çështjet që ndodhen në kompetencat e saja dhe që vendimi mbi referendumin sjellet nëse për të janë deklaruar shumica e qytetarëve që kanë votuar, me kusht që më shumë se gjysma qytetarëve të kenë votuar për atë vendim. Për të gjithë format e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve, ligji parasheh rregullimin detal nëpërmjet statuteve të komunave dhe qyteteve.

Me anë të iniciativave qytetare, Kuvendit komunal i propozohen sjelljet e akteve nëprmet të cilave rregullohen çështjet e caktuara nën kompetencat e vetqeverisjes lokale, ndryshimin e statutit ose edhe akteve tjera e poashtu edhe shpallja e referendumit në përputhshmëri me ligjin dhe statutin.

Dispozitat mbi tubimin e qytetarëve poashtu janë identike në ligj dhe ato definojnë çështjet mbi rregullimin e tubimeve të qytetarëve, mënyrën e miratimit të propozimeve dhe afatin kohorë mbrenda të cilit vetqeverisja lokale duhet të shqyrtoj propozimet dhe kërkesat.

## 2. FORMAT E PJESËMARRJES SË QYTETARËVE: INICIATIVAT QYTETARE, REFERENDUMI, TUBIMI I QYTETARËVE, DISKUTIMET PUBLIKE, ANKETIMET PUBLIKE

Në bazë të statutit të komunës së Bujanocit, Preshevës dhe Medvegjës, si forma të pjesmarrjes së drejtëpërdrejt të qytetarëve në vetqeverisje lokale përmenden: iniciativat qytetare, referendumi, tubimi i qytetarëve dhe diskutimet publike, e që komuna e Medvegjës si mënyrë shtesë të participimit qytetarë parasheh edhe anketimet publike.

### INICIATIVAT QYTETARE

Nëprmet iniciativave qytetare **dorëzohen nënshkrimet me qëllim të ndryshimit të akteve ligjore në vetqeverisje lokale, ndryshim të statutit, si dhe sjellja e masave të cilat ndodhen në kompetencat e kuvendit.** Kuvendi obligohet që të organizoj diskutim mbi çështjet e kërkuara dhe t'i dorëzoj përgjigje qytetarëve në afat prej 60 ditëve. Me anë të statutit definohet numri i nënshkrimeve të nevojshëm për incimin e iniciativës qytetare, numër ky që nuk mund të jetë më i vogël se **5% i numrit të përgjithshëm të votuesve të regjistruar në atë komunë.**

Në bazë të praktikave të deritanishme është treguar që qytetarët e komunave më të vogla janë më aktiv dhe më shpesh kanë dorëzuar iniciativa në krahasim me qytetarët e vendeve më të mëdha.

Iniciativat qytetare më së shpeshti iniciohen për çështjet me të cilat qytetarët ballafaqohen çdo ditë: çështje komunale, çështje rreth trafikut, ndihmë për manifestime të ndryshme, etj. Në raste të caktuara, iniciohet ndërimi i organizimit territorial të komunës ose qytetit. Iniciativa qytetare është instrument nëprmet të cilit qytetarët fitojnë të drejtën që t'i drejtohen kuvendit komunal dhe t'i propozojnë aprovimin e ndonjë akti të përgjithshëm (statuti, vendimi, etj) ose të propozojnë amandamente rreth akteve të lartëpërmendur dhe të kërkojnë që një propozim i tillë, nëse trupi përgjegjës komunal nuk e pranon, të hudhet në votim të qytetarëve. Në bazë të kësaj, një propozim i tillë do të aprovohet nëse pranohet ose nga trupi përgjegjës komunal, ose me shumicë votash.

Në këtë mënyrë qytetarët mund të ndryshojnë gjendjen aktuale, pa marr parasysh nëse pushteti lokal ka aprovuar apo jo ndonjë vendim, dhe një ndryshim i tillë me këtë metodë mund të bëhet qoftë edhe kundër vullnetit të pushtetit lokal.

*Shembull: nëse komuna nuk mundohet të zgjidhë problemin e caktuar në trafik, qytetarët e pakënaqur vendosin të nisin iniciativë qytetare dhe formulojnë propozimin iniciues, në bazë të cilit problemi në fjalë duhet të zgjidhet. Nëse mbledhin numrin e nevojshëm të nënshkrimeve, kuvendi komunal është i obliguar të deklarohet (votoj) rreth atij propozimi. Nëse kuvendi komunal hedh poshtë propozimin iniciues, atëher organizohet votimi qytetarë. Vendimi për komunën është obligativ, nëse në atë proces të votimit aprovohet propozimi i qytetarëve.*



### T'i kushtohet vëmendje!

Iniciativa qytetare nuk është e njëjtë me peticionin. Peticioni është formë e shkruar nëprmet të cilës qytetarët kërkojnë nga organet e qeverisjes të nisë procedurë ose të ndërmarra hapa të caktuara në kuadër të kompetencave të veta. Vetë forma e peticionit nuk është e definuar me ligj për dallim të iniciativës qytetare të cilën e rregullon ligji.

## REFERENDUMI

**E drejta për referendum është e drejtë e qytetarëve të votojnë mbi vendimin të cilin e ka aprovuar kuvendi popullor ose lokal dhe në këtë mënyrë vendosin nëse e pranojnë apo jo këtë vendim.**

Kuvendi komunal mund të shpallë referendum mbi çështjet që janë në kompetenca të komunave, dhe është e obliguar për një gjë të tillë nëse propozohet nga më së paku 10% e numrit të votuesve nga numri i përgjithshëm i votuesve në atë njësi lokale. Kuvendi komunal i njësive të vetqeverisjeve lokale mund me vetëiniciativë të shpall referendum mbi çështjet që ndodhen brenda kompetencave të saja. Vendimin mbi shpalljen e referendumi komunal, Kuvendi komunal e merr me shumicë votash të numrit të përgjithshëm të këshilltarëve. Vendimi merr nëse për referendum kanë votuar shumica e qytetarëve të cilët kanë mar pjesë, me kusht që të kenë votuar më shumë se gjysma nga numri i përgjithshëm i banorëve. Vendimi i dalë nga referendumi është i obligueshëm, ndërsa Kuvendi komunal nuk mund ta çfuqizojë të njejtin, e as nuk mund ta plotsojë ose ndryshojë thelbin e saj në periudhë kohore njëvjeçare nga dita kur është aprovuar vendimi i marr. Numri më i madh i Referendumeve të realizuara ka pas të bëjë me kontributet e qytetarëve dhe me ndryshimin e organizimit territorial e cila ka të bëjë me bashkimin apo ndarjen e bashkësive lokale. Organet për realizimin e referendumi janë komisionet dhe këshilli votues. Komisionin e trajnon organi i cili ka shpallur referendumin, ndërsa komisioni mirret me trajnimeve e këshillave votues.

→ **T'i kushtohet vëmendje!**

Pyetjet për të cilët deklarohen qytetarët në referendum duhet të jenë të qarta dhe formuluar mirë, në mënyrë që qytetarët të deklarohen nëse janë “për” ose “kundër”, ose janë për “po” ose “jo”.

## TUBIMI QYTETARË

Tubimi i qytetarëve ftohet për pjesën e territorit të njësisë së vetqeverisjes lokale të paraparë me statut. **Tubimi i qytetarëve diskuton dhe jep propozime dhe kërkesa mbi çështjet që janë në kompetenca të vetqeverisjeve lokale.** Tubimi qytetarë me shumicë vota të të pranishmeve mund të aprovoj propozime, kërkesa, të njejtat t'ia drejtoj Kuvendit ose organeve të caktuara të pushtetit lokal. Organet dhe shërbimet e pushtetit lokal janë të obliguara që në një afat prej 60 ditëve nga dita e mbajtjes së tubimit qytetarë të shtjellojnë kërkesat ose propozimet e qytetarëve dhe të deklarohen rreth tyre, rrespektivisht të sjellin vendimin e caktuar dhe për të njejtin t'i njoftojnë qytetarët. Mënyra e organizimit të tubimit qytetarë, funksionimi, dhe mënyra e vërtetimit të qëndrimit të këtij trupi rregullohet me statutin edhe vendimin e Kuvendit komunal. Tubimi qytetarë ftohet sipas nevojës së bashkësive lokale, një pjese të bashkësisë lokale ose më shumë bashkësive lokale së bashku, në bazë të mënyrës së caktuar me anë të statutit të komunës.

## DISKUTIMET PUBLIKE

**Diskutimi publik është mekanizëm nëpërmjet të cilit përfaqësuesit e pushtetit lokal vijnë deri tek informacionet, mendimet dhe zgjidhjet të cilat i përkasin vendimeve të caktuara.** Shfrytëzohet në mënyrë që ushtruesit e pushtetit dhe qytetarët lokal të informohen mbi pasojat eventuale që mund t'i sjellin ndryshimet e propozuara. Komuna nuk ka obligim që propozimet të cilët jipen nga qytetarët në diskutime publike t'i realizoj, që don të thot që marrja e vendimeve dhe përgjegjësisë mbetet në organin kompetent të komunës.

Edhe një karakteristikë e diskutimit publik është që qytetarët, personat profesional dhe përfaqësuesit e pushtetit nëpërmjet diskutimeve publike mund të gjejnë zgjidhje më të mira dhe më efikase. Pjesëmarrja e publikut duhet të shihet si positive, duke e marrë parasysh që kjo është një mundësi e cila i hap dyert të gjithë të interesuarëve (qofshin ato individ apo grupe) që me pjesëmarrjen e tyre t'i kontribuojnë kualitetit të jetesës. Këto janë përparësitë e pjesëmarrjes së qytetarëve në marrjen e vendimeve.

Në bazë të statuteve të komunave Bujanoc, Preshevë dhe Medvegjë, diskutimet publike duhen patjetër organizuar në rastet si në vijim: me rastin e aprovimit të buxhetit të komunës, gjatë aprovimit të planeve strategjike aksionale për zhvillim, si dhe planifikimit hapsinorë të komunave.

### ANKETIMET PUBLIKE

Komuna e Medvegjës është specifike në realizimin e anketimeve publike. **Anketimet paraqesin mundësi për organet komunale që rreth çështjeve që janë në kompetenca të komunës të konsultohen qytetarët.**

Anketat realizohen, në njërin anë, që të grumbullohen të dhëna mbi nevojat dhe problemet e qytetarëve, që të radhiten prioritetet e realizimit të projekteve të cilat hyjnë në planifikimet strategjike të zhvillimit të komunës dhe finansohen nga buxheti programor në vitet e ardhshme, rrespektivisht, në anën tjetër, që të testohet se sa janë të kënaqur qytetarët me shërbimet të cilat i ofron komuna dhe të grumbullohen propozimet për avancimin e punës së tyre. Anketat janë anonime, janë të formuluar në të dy gjuhët zyrtare (sërbisht dhe shqip). Anketat mund të sigurohen nëpër qendrat e asistencës, zyret për zhvillim ekonomik lokal dhe në disa punkte tjera në komunë. Rreth anketimit qytetarët njoftohen nëpërmjet mjeteve të informimit dhe ueb sajtit të komunës, ndërsa rezultatet e të njejtave poashtu bëhen publike.

*Rekomandim: është e nevojshme të nxiten dhe promovohen forma të ndryshme të aktivizimit qytetarë, sepse edhe pse këto mekanizma ekzistojnë dhe janë të rregulluara me ligje dhe akte të komunave, përparësitë e tyre nuk janë duke u shfrytëzuar në masë të plotë.*

*Angazhimi i qytetarëve në procesin e marrjes së vendimeve është i rëndësishëm për përmirësimin e mardhënieve midis qytetarëve dhe pushtetit. Në këtë mënyrë mund që, me kalimin e kohës, të shndërrohet në kulturë të participimit të qytetarëve në marrjen e vendimeve dhe mund t'i kontribuoj rritjes së përgjegjësisë së pushtetit ndaj qytetarëve.*

**Vetqeverisja lokale është e drejtë e qytetarëve të menaxhojnë me punët publike me interes të përgjithshëm dhe përbashkët për qytetarët lokal, në mënyrë të drejtpërdrejt nëpërmjet përfaqësuesëve të zgjedhur në njësitë e vetqeverisjeve lokale, si dhe e drejtë dhe aftësi e organeve të pushtetit lokal që, në përputhshmëri me ligjin, të rregullojnë dhe udhëheqin me punët publike të cilat janë nën kompetencat e tyre.**

Qytetarët me të drejtë vote dhe me vendbanim në territorin e njësisë së vetqeverisjes lokale, udhëheqin me punët e pushtetit lokal. E drejta e votës është njëra prej të drejtave më të rëndësishme politike e qytetarëve. Zgjedhjet lokale realizohen si të drejtpërdrejta, sepse votuesit vetë zgjedhin këshilltarët në kuvendin e komunës ose qytetit. **E drejta e votës manifestohet në dy forma: e drejta e votës aktive dhe pasive.**

E drejta e përgjithshme e votës d.m.th që e drejta e votës në zgjedhjet lokale (**e drejta e votës aktive**) i pranohet të gjithë personave nga moshë 18 vjeçare, qytetarëve të Republikës së Serbisë që kanë vendbanim në territorin e njësisë së caktuar të vetqeverisjes lokale. E drejta aktive e votës kryhet nëpërmjet votimit. Votimi është proces zgjedhor i cili kryhet me dhënien e votës asaj liste zgjedhore për kandidatët e së cilës orientohet votuesi dhe për të cilët dëshiron që nesër të bëhen këshilltarë në Kuvendin komunal të njësisë së caktuar lokale.

**E drejta e votës pasive** është e drejtë e qytetarit që të zgjidhet për këshilltar. Kandidat për këshilltarë mund të jetë person i moshës madhore i cili është qytetarë i Republikës së Serbisë dhe ka vendbanim në territorin e komunës në të cilën zhvillohen zgjedhjet lokale. Kandidati mund të konkuroj vetëm në njërin listë zgjedhore.

**Zgjedhjet lokale janë një lloj i procesit zgjedhor nëpërmjet të cilave zgjidhen organet e përfaqësimit të vetqeverisjes lokale.** Organet për organizimin dhe realizimin e zgjedhjeve lokale janë: Komisioni zgjedhor lokal dhe këshillat votuese.

Komisioni lokal zgjedhor është trup i vecant, detyra e të cilit është të organizoj zgjedhjet lokale dhe të siguroj që procesi zgjedhor të shkoj



me rregull dhe në suaza të ligjit. Ky trup punon në përbërje të rregullt dhe atë të zgjeruar. Asnjë parti politike ose koalicion zgjedhor nuk mund të ketë më shumë se gjysmën e anëtarëve në përbërjen e rregullt të organit që miret me realizimin dhe mbarëvajtjen e zgjedhjeve. Komisionin zgjedhor në përbërje të rregullt e përbëjnë: kryetari, antarët, sekretari dhe zëvendsat e tyre. Ky organ përvec kryetarit të saj duhet të ketë patjetër edhe më së paku 6 anëtarë. Komisionin zgjedhor në përbërje të zgjeruar, përvec anëtarëve të emruar, e përbëjnë edhe antarët e autorizuar si dhe përfaqësuesit e listave të shpallura zgjedhore. Komisioni lokal zgjedhor në mes tjerash ka për detyrë që të: caktoj vendet votuese; t'i jap rekomandime trupave zgjedhore në aspektin e procedurave për zgjedhjen e këshilltarëve; të konstatoj nëse listat zgjedhore përmbajnë të gjitha informacionet në përputhshmëri me rregullat mbi zgjedhjen e këshilltarëve; të shpall listat zgjedhore; të konstatoj dhe t'i shpall rezultatet e përgjithshme të zgjedhjes së këshilltarëve.

### → T'i kushtohet vëmendje!

Në internet prezantimin e komunës së Bujanocit gjindet në dispozicion linku me të dhënat dhe dokumentacionin përcjellës për punën e Komisionit lokal zgjedhor: [http://bujanovac.rs/cms/lat/opstinska\\_izborna\\_komisija](http://bujanovac.rs/cms/lat/opstinska_izborna_komisija)

Këshilli votues realizon drejtpërdrejtë votimin nëpër vendvotime. Anëtarët në përbërje të rregullt dhe zgjeruar të këshillave votuese i emëron komisioni zgjedhor. Përbërjen e rregullt të këshillave votuese e përbëjnë: kryetari, më së paku 4 anëtarë dhe zëvendsat e tyre. Anëtarët e këshillave votuese në përbërje të zgjeruar emrohen me propozim të përfaqësuesve të listave zgjedhore për të cilat është konstatuar që i plotësojnë kushtet që të emërojnë përfaqësuesit e tyre në organet për realizimin e zgjedhjeve. Anëtarë i komisionit zgjedhor, rrespektivisht i këshillave votuese nuk mund të jetë kandidati për këshilltar. Këshilli

votues duhet të merr materialin zgjedhor dhe ta ruaj deri kur të hapen vendvotimet, të përgadis vendvotimin, të hap të njejtin, të realizoj dhe mirëmbajë procesin e votimit, të mbyll vendvotimin, të konstatoj rezultatet, të plotësoj procesverbalin mbi punën e këshillit votues dhe t'ia kthej materialin zgjedhor komisionit komunal zgjedhor

### → T'i kushtohet vëmendje!

Ndodh shpesh që qytetarët të mos jenë të njoftuar me ndryshimet të cilat i përkasin vendvotimeve të caktuara. Deri tek këto informacione mund të vijnë nëpërmjet komisionit komunal zgjedhor, dhe në këtë mënyrë evitohet mundësinë që gjatë ditës së zgjedhjeve të mos mund të gjejnë vetën nëpër lista të votimit.

Në faqën e internetit <http://birackispisak.mduls.gov.rs/javniportal> ndodhen të dhënat mbi vendvotimin e votuesit në bazë të vendbanimit. Kjo nënkupton që secili qytetarë mundet që nëpërmjet numrit personal të verifikoj në cilin vendvotim mund ta realizoj të drejtën e votës. Nëse nëpërmjet këtij verifikimi vërehet ndonjë gabim (për shembull, që personi nuk është në listën zgjedhore), është e nevojshme që qytetari të shtroj kërkesë për ndryshimin në listën zgjedhore (regjistrimin, ndryshimin, plotsimin, përmirsimin ose edhe fshirjen) edhe atë t'ia drejtoj administratës komunale.

Në vendimin mbi shpalljen e zgjedhjeve vendoset dita e mbajtjes së zgjedhjeve dhe dita prej kur fillon aktiviteti zgjedhor. Nga ky moment komisioni zgjedhor duhet të organizohet dhe t'i përgadis të gjitha, në mënyrë që votuesit mund të votojnë në ditën kur edhe janë caktuar zgjedhjet. Zgjedhjet nuk mund të realizohen nëse nuk ka lista zgjedhore nëpërmjet të cilave votuesit do të mund të votonin. Me rregullat mbi

kandidimin rregullohet kush mund të dorëzoj listë zgjedhore, cilat janë kushtet për dorzimin e listës zgjedhore, etj.

Listat e këshilltarëve mund t'i dorëzojnë: partitë e regjistruara politike, koalicionet e partive të regjistruara dhe grupet qytetare.

**Parti politike** janë organizatat e qytetarëve të cilat në mënyrë të lirë dhe vullnetare janë bashkuar për të realizuar qëllimet e tyre politike nëpërmjet pjesmarrjes në zgjedhje dhe shprehjes së vullnetit demokratik të qytetarëve. Që të mund të propozoj kandidat për këshilltar, partia politike duhet të jetë e regjistruar në Regjistrin e partive politike.

**Koalicioni i partive të regjistruara politike** është formë e bashkimit të subjekteve politike me qëllim të pjesmarrjes së përbashkët në zgjedhje, mardhëniet e të cilave rregullohen me kontratë të vërtetuar në bazë të ligjit me anë të së cilit rregullohet edhe vërtetimi i nënshkrimeve.

**Grupi qytetarë** është formë e bashkimit të votuesve me qëllim të pjesmarrjes së përbashkët në zgjedhje. Mardhëniet e tyre të ndërsjella rregullohen poashtu me kontratë të vërtetuar në bazë të ligjit me të cilin rregullohet edhe vërtetimi i nënshkrimeve.

Në Regjistrin e partive politike i cili ndodhet në faqën e internetit të Ministrisë së administratës shtetërore dhe vetqeverisjes lokale, janë gjithsej 8 parti të cilat vëndndodhjen e tyre e kanë të regjistruara në Bujanoc (4) dhe Preshevë (4), ndërsa në Medvegjë nuk ka të regjistruar asnjë parti politike.

<http://www.mduls.gov.rs/doc/dokumenta/pstranke/IZVOD%20IZ%20REGISTRA%20170206.pdf>.

### PARTIT POLITIKE TË REGJISTRUARA NË BUJANOC

1. Unioni demokratik Shqiptar, parti politike e pakicës nacionale Shqiptare;
2. Lëvizja e Progresit Demokratik, parti politike e pakicës nacionale Shqiptare
3. Partia demokratike, parti politike e pakicës nacionale Shqiptare
4. Partia e bashkuar Rome - Jekutni Partija Romani, parti politike e pakicës nacionale Shqiptare

### PARTIT POLITIKE TË REGJISTRUARA NË PRESHEVË

1. Partia për Veprim Demokratik, parti politike e pakicës nacionale Shqiptare
2. Bashkimi Demokratik i Luginës, parti politike e pakicës nacionale Shqiptare
3. Partia demokratike Shqiptare, parti politike e pakicës nacionale Shqiptare
4. Alternativa për ndryshim, parti politike e pakicës nacionale Shqiptare

## 4.

### ROLI I BASHKËSIVE LOKALE

**Bashkësia lokale paraqet formën e vecant të institucionalizuar të grumbullimit të qytetarëve të cilët jetojnë në një teritor të njejtë.** Për plotsimin e nevojave të qytetarëve lokal formohen bashkësit lokale, edhe atë: për një pjesë të banuar, për një vend të banuar dhe për më shumë vende të banuara. Kuvendi komunal, rrespektivisht Kuvendi i qytetit, vendosë në bazë të mendimit të qytetarëve të marë më herët,

mbi formimin ose jo të bashkësive të caktuara lokale. Bashkësia lokale formohet në vende në të cilat ekziston interesim që në mënyrë sa më të mirë të plotsohen dhe realizohen nevojat e qytetarëve. Këto trupa përfaqësohen nga personi juridik i cili vepron në kuadër të kompetencave dhe detyrimeve të caktuara me vendimin mbi themelimin e një bashkësie lokale. **Qytetarët në bashkësitë lokale në mënyrë të drejtpërdrejt ose nëpërmjet organeve të bashkësive lokale mund të realizojnë të drejtat e veta. Në mes tjerash edhe duke:**

- nisur iniciativa për sjelljen ose ndryshimin e rregullave dhe akteve të përgjithshme në kompetenca të komunës;
- iniciuar ndarjen ose bashkimin e vendeve të banuara nga përbërja e komunës;
- iniciuar ndërtimin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e rrugëve lokale, objekteve tjera komunale dhe mënyrën e sigurimit të mjeteve financiare për këtë qëllim
- nisur iniciativa për rregullimin e lagjeve, mirëmbajtjen e pastërtisë së rrugëve, rregullimin dhe mirëmbajtjen e hapsirave të gjelbruara;
- organizuar shpalljen dhe realizimin e referendumeve;
- ruajtjur dhe avancuar ambientin;
- mirëmbajtur dhe shfrytëzua hapsirat e punës që bashkësive lokale iu janë dhënë në shfrytëzim;
- mundësuar përmbushjen e nevojave dhe intereseve në sferën e mbrojtjes civile, respektivisht mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe të tjera;
- siguruar përkujdesje shoqërore për fëmijët dhe qytetarët e grupeve të ndryshme sociale;
- realizuar nevojat e përbashkëta në sferën e kulturës, edukimit fizik, organizimit të manifestimeve kulturore dhe garave sportive;
- përbushur nevojat e tjera të përbashkëta të cilat definojnë me statut ose akte tjera të bashkësive lokale.
- Me qëllim të transparencës dhe disponueshmërisë, lista e bashkësive lokale në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegje ndodhet në pjesën vijuese të publikimit. Për marrjen e kontakteve të

kryetarëve të bashkësive lokale, është e nevojshme që qytetarët t'i drejtohen komunave (kontaktet e komunave ndodhen në fund të këtij publikimi).

#### **LISTA E BASHKËSIVE LOKALE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË MEDVEGJËS**

NUMRI RENDOR	BASHKËSIA LOKALE	KRYETAR I BASHKËSISË LOKALE
1.	BOGUNOC	Novica Bogosavljeviq
2.	BOROVAC	Milutin Zariq
3.	BUQUMET	Slagjan Svilenkoviq
4.	VRAPCE	Nuk është zgjedhur kryetari i ri
5.	BRAINA E MADHE	Radoje Knezheviq
6.	GAZDARE	Nebojsa Koviniq
7.	GAJTAN	Stevan Zhugiq
8.	GUBAVCE	Zoran Uskokoviq
9.	GRBAC	Fetije Avdili
10.	DRENCE	Slavisha Radojeviq
11.	GJULEKARE	Dragan Ivanoviq
12.	KAPIT	Kadri Hiseni
13.	LECE	Mile Radoviq
14.	MAROVCI	Dragan Ristiq
15.	MAQEDONCI	Milivoje Gikiq

NUMRI RENDOR	BASHKËSIA LOKALE	KRYETAR I BASHKËSISË LOKALE
16.	MEDEVCE	Nedeljko Periq
17.	MEDVEGJA	Goran Ivanoviq
18.	MRKONJE	Radoje Periq
19.	NEGOSAVLJE	Radovan Stankoviq
20.	PETRILJE	Milivoje Nikoliq
21.	PUSTO ŠILOVO	Dragan Zhivkoviq
22.	RAMABAJA	Marko Marko
23.	RUJKOVAC	Dragan Mlladenoviq
24.	RETKOCERI	Slavisha Milovanoviq
25.	SVIRC	Hajdar Hajdari
26.	SIJARINË	Zoran Stankoviq
27.	BANJA E SIJARINËS	Dragan Deniq
28.	SPONCE	Mileta Raiceviq
29.	BANJA E VJETËR	Milan Draganiq
30.	STUBLLA	Dushan Miniq
31.	TULARE	Milorad Mitrovic
32.	TUPALLË	Sokol Halimi
33.	CRNI VRH	Dragan Vuckoviq
34.	QOKOTIN	Bogosav Stankoviq

### LISTA E BASHKËSIVE LOKALE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË BUJANOCIT

NUMRI RENDOR	BASHKËSIA LOKALE	KRYETAR I BASHKËSISË LOKALE
1.	BUJANOC	Bozhidar Tashkoviq
2.	RAKOC	Tomislav Arsiq
3.	LEVOSOJË	Goran Atanaskoviq
4.	KARADNIK	Ivica Stankoviq
5.	ZHUZHELICË	Boban Aleksiq
6.	BARALEVC	Bogoljub Mitiq
7.	KLINOC	Vlastimir Mishiq
8.	SRPSKA KUCA	Nenad Marinkoviq
9.	KRSHEVICË	Andrija Stevanoviq
10.	SPANCEVC	Sinisha Stojilkoviq
11.	LLOPARDINCË	Goran Janjiq
12.	LILANCË	Stojadin Dimciq
13.	BILAÇ	Jakup Xhelili
14.	BRNJAR	Dragoljub Iliq
15.	KLENIK	Sasha Arsiq
16.	JABLLANICË	Dragan Jovciq
17.	ZHBEVC	Zoran Angjellkoviq
18.	LLUCAN	Ridvan Isufi

NUMRI RENDOR	BASHKËSIA LOKALE	KRYETAR I BASHKËSISË LOKALE
19.	LETOVIC	Amet Mustafa
20.	NESALCË	Basri Veseli
21.	BREZNICË	Bedri Sulejmani
22.	KONÇUL	Zylqefli Sherifi
23.	ZARBICË	Selami Bajrami
24.	MUHOC	Xhevat Asani
25.	SAMOLICË	Ekrem Bislimi
26.	DOBROSIN	Ferat Ferati
27.	TËRNOÇ I MADHË	Agim Haliti
28.	OSLLARË	Hasan Pajaziti
29.	TURI	Shefket Ibishi

NUMRI RENDOR	BASHKËSIA LOKALE	KRYETAR I BASHKËSISË LOKALE
5.	MAXHERE	Avdi Xhelili
6.	STACIONI I HEKURUDHAVE	Skender Limani
7.	ZHUNICË	Selajdin Mustafa
8.	BUKOC	Isa Ajvazi
9.	KURBALI	Lutfi Hafizi
10.	MIRATOC	Merxhan Memishi
11.	CARAVAJKË	Zeqirja Rashiti
12.	SLLAUVUJEVC	Nenad Stankoviç
13.	BUKUROÇ	Armend Ibrahim
14.	RAINÇË	Lulzim Veliu
15.	TËRRNAVË	Rabit Rexhepi
16.	RAHOVICË	Vebi Rexhepi
17.	BUSHTRAN	Sejdi Emiri
18.	ASHANËT	Qemal Memeti
19.	CAKANOC	Boban Zlatkoviç
20.	LUMI I TËRRNAVËS	Branko Trajkoviç
21.	SVINJISHTË	Zoran Velickoviç
22.	LERAN	Ajdin Ameti
23.	PRESHËVË I	Shefket Selimi

**LISTA E BASHKËSIVE LOKALE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PRESHEVËS**

NUMRI RENDOR	BASHKËSIA LOKALE	KRYETAR I BASHKËSISË LOKALE
1.	NORÇË	Arif Ibishi
2.	SHOSHAJA E POSHTME	Ardian Agushi
3.	GERAJ	Bajram Jashari
4.	GOLEMIDOLL	Agim Saqipi

NUMRI RENDOR	BASHKËSIA LOKALE	KRYETAR I BASHKËSISË LOKALE
24.	PRESHËVË II	Qani Neziri
25.	PRESHËVË III	Xhevat Ajeti
26.	ÇUKARKË	Ridvan Biljali
27.	CORROTICË	Shemsi Etemi
28.	STREZOC	Dragan Velickoviq

*Bashkësitë lokale luajnë një rol të rëndësishëm në formë të realizimit të drejtpërdrejt të qytetarëve, sepse problemet e caktuara së pari paraqiten në nivel të bashkësive lokale.*

## 5.

### RËNDËSIA E BASHKËPUNIMIT ME ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE

Në përvojën e deritanishme është treguar se bashkëpunimi në mes sektorit publik dhe atij joqeveritarë në të gjitha nivelet e pushtetit është njëri prej parakushteve për vazhdimin e zhvillimit të shoqërisë civile në Republikën e Sërbisë, por edhe avancimit të përgjithshëm të funksionimit të institucioneve me qëllim të marrjes së vendimeve në mënyrë transparente dhe implemtimin e tyre në mënyrë efikase.

Njësitë e vetqeverisjes lokale dhe bashkësia lokale në përgjithësi paraqesin akterët kryesor në proceset që janë me rëndësi për jetën e njerëzve. Vendimet të cilët mirren në nivel lokal në mënyrë të drejtpërdrejt ndikojnë në kualitetin e jetës dhe kanë rëndësi të veçantë për qytetarët.

**Inkuadrimi i shoqërisë në punën publike** është parakusht i cili duhet të plotësohet në mënyrë që qytetarët të jenë të informuar mbi

rezultatet e arritura dhe të kuptojnë rëndësinë dhe nevojën për pjesmarrje aktive, edhe atë nëpërmjet pjesmarrjes në diskutime publike, pjesmarrjes në punën e sektorit civil dhe nëpërmjet paraqitjes së qëndrimeve të tyre që kanë për qëllim avancimin e bashkëpunimit në të gjitha nivelet.

Duke e pasur parasysh që Ligji mbi vetqeverisjen lokale i jep mundësi njësitë të vetqeverisjes lokale të bashkëpunojnë me sektorin joqeveritarë, si dhe të formojnë trupa të rregullt ose të përkohshëm për shqyrtimin e gjërave që janë në kompetencë të tyre, inkuadrimi i organizatave të shoqërisë civile në punën e trupave punues do të mundësonte që edhe qëndrimet e qytetarëve të ndëgjohen në vendet ku mirren vendimet. Sikur bashkëpunimi me OJQ-të të ishte më intensiv, rezultati i këtij bashkëpunimi do të ishte ndërtimi i institucioneve të forta demokratike.

Është e nevojshme të ngritet vetëdija nëpër vetqeverisjet lokale mbi rrolin e OJQ-ve në bashkësitë e tyre lokale, si dhe mbi nevojën e organizimit të bashkëpunimit në forma të ndryshme. Definimi strategjik i mardhënieve dhe mekanizmave të bashkëpunimit me OJQ-të, do të sjellte deri tek integrimi i shoqërisë civile në të gjitha proceset të cilët janë me interes vital për shoqërinë.

Është e nevojshme që në njërin anë OJQ-të të forcojnë kapacitetet e tyre për pjesmarrje në proceset e marrjes së vendimeve, ndërsa në anën tjetër të informojnë më shumë bartësitë e funksioneve dhe të punësuarit nëpër vetqeverisje lokale për punën e tyre, në mënyrë që akteret relevant në sferën e politikave publike të mundë të identifikojnë rolin e Organizatave joqeveritare. Paraqitjet e përbashkëta të sektorit civil në prezentimin e projekteve dhe qëndrimeve të tyre në kuadër të grupeve punues që janë të formuara brenda vetqeverisjeve lokale, do të avancojnë koordinimin e ndërsjellë dhe do t'i kontribuonin dukshëm lidhshmërisë më të mirë brenda sektorit civil.

Krijohet përshtypje që nuk është praktikë e obligueshme inkuadrimi i sektorit civil, si një prej palëve të interesuara, në proceset e planifikimit strategjik në nivel lokal. Poashtu duhet theksuar se edhe përfaqësuesit e sektorit civil kanë treguar interesim të vogël në krijimin e politikave të caktuara publike.

→ *T'i kushtohet vëmendje!*

Udhëzimet për inkuadrimin e organizatave të shoqërisë civile në proceset e marrjes së vendimeve dhe Udhëzuesi për aplikimin rekomandimeve janë dokumente me të cilët duhet të njoftohen përfaqësuesit e organeve të vetqeverisjeve lokale, por edhe ato të shoqërisë civile. Udhëzimet janë në dispozicionin në linkun e mëposhtëm: <http://civilnodrustvo.gov.rs/podsticajno-okruzenje/pravni-okvir/smernice.370.html>

6.

## KOMUNIKIMI NË MES TË KËSHILLIT NACIONAL DHE QYTETARËVE

**Këshilli Nacional përfaqëson pakicën nacionale në sferën e arsimit, kulturës, informimit në gjuhën e pakicës nacionale dhe shfrytëzimin zyrtar të gjuhës dhe shkrimit, merr pjesë në porcesin e marrjes së vendimeve ose sjell vendime mbi këto çështje nga këto sfera.** Formon institucione, shoqëri ekonomike dhe organizata tjera nga këto sfera. Me qëllim të realizimit të të drejtës për vetëudhëheqje në katër sferat e lartpërmendura, pjestarët e pakicave nacionale mund të zgjedhin Këshillin e tyre nacional. Këshilli Nacional i pakicës nacionale shqiptare (KNSH) luan rol në ruajtjen e identitetit kulturor të pakicës nacionale shqiptare dhe i kontribuon realizimit të të drejtave për pjesmarrje në shoqëri. KNSH zgjidhet nga ana e përfaqësuesve të pakicës nacionale shqiptare në zgjedhje të drejtpërdrejta. Funkcionimi i KNSH-së është i rëndësishëm për realizimin e politikave multikulturore dhe integrimin e pakicës nacionale.

→ *T'i kushtohet vëmendje!*

Këshilli Nacional i pakicës nacionale shqiptare është organ të cilit mund t'i drejtoheni në lidhje me çështjet e caktuara nga sfera e kulturës, arsimit, informimit dhe shfrytëzimit zyrtar të gjuhës dhe shkrimit. Çështjet tjera nuk janë në kompetenca të KNSH-së. Vendndodhja e KNSH-së është në Bujanoc, rruga K. Petroviq, 237, kati i dytë. Kontakti dhe email adresa: 017/653-264; [kksh.bujanoc@gmail.com](mailto:kksh.bujanoc@gmail.com).

Përfaqësuesit e bashkësisë shqiptare mund u drejtohen rregullisht për ndihmë dhe këshilla përfaqësuesve të tyre në KNSH, por më së shpejti ankesat dhe nevojat e tyre nuk janë në kompetenca të KNSH-së, si psh problemet rreth nënshtetësisë, situatat e vështira ekonomike, etj. Strategjia e komunikimit me bashkësinë të cilën e përfaqësojnë, duke e marr parasysh të gjitha karakteristikat e saja, mund të realizohet nëpërmjet lidhjes me organizatat lokale të shoqërisë civile dhe personave fizik, me qëllim të inkuadrimit në masë sa më të madhe në punën dhe aktivitetet e KNSH-së. Patur parasysh që pakica nacionale shqiptare është e koncentruar në pjesë të caktuara të territorit të Republikës së Serbisë, është më e lehtë mundësia e ndërtimit të bashkëpunimit dhe kontakteve ndërmjet qytetarëve dhe përfaqësuesve të Këshillit. Qytetarët duhet në mënyrë më efikase të shfrytëzojnë Këshillin nacional dhe t'i mundësojnë ktij organi, që duke shfrytëzuar mekanizmat e veta, në mënyrë sa më efikase të kryej punën e vet. Me qëllim të komunikimit sa më të mirë me pjestarët e bashkësisë së vet, me një interakcion direkt KNSH-ja mund të promovoj punën dhe kompetencat e veta. Në anën tjetër është edhe përgjegjësi dhe obligim i anëtarëve të ktij organi, që nëpërmjet aktiviteteve të veta, t'i kontribuojnë realizimit dhe ruajtjes të të drejtave të bashkësisë të cilën e përfaqësojnë.

Komuna	Kontaktet	
<b>Bujanoc</b>	<i>Adresa</i>	Karagjorgje Petroviq 115, 17520 Bujanoc
	<i>Telefoni</i>	+381 17 651 – 013
	<i>Sajti</i>	<a href="http://bujanovac.rs/">http://bujanovac.rs/</a>
	<i>Email</i>	<b>mayor.bujanovac@gmail.com</b>
<b>Preshevë</b>	<i>Adresa</i>	Marshall Tita 36, 17523 Preshevë
	<i>Telefoni</i>	+381 17 660 820
	<i>Sajti</i>	<a href="http://presevo.rs/">http://presevo.rs/</a>
	<i>Email</i>	<b>info@presevo.rs</b>
<b>Medvegjë</b>	<i>Adresa</i>	Jablanicka 48, 16240 Medvegjë
	<i>Telefoni</i>	+381 16 891 138
	<i>Sajti</i>	<a href="http://www.medvedja.org.rs/">http://www.medvedja.org.rs/</a>
	<i>Email</i>	<b>kabinet@medvedja.org.rs</b>